VENDIM
Nr.1544, datë 19.11.2008

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.229, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT ZYRTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 2, e 49 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1.4 të kapitullit VII "Ceremonitë kryesore zyrtare", të ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet si një ditë e shënuar edhe data:

"20 nëntor Dita e Alfabetit.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha